

LIGJ
Nr. 117/2020

PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIMI I RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 100/2017

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pikat 1 dhe 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Denoncohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 100/2017.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.9.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11738, datë 22.9.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta

Numri i referencës: 22304
Data: 22.4.2020
Bashkëlidhur.....

SFD
Fondi Saudit për Zhvillim

MESAZH ME FAKS

Drejtuar: SH.T. Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Republika e Shqipërisë

Numri i faksit: (+35542228405)

LËNDA: Përfundimi/Zgjidhja e Marrëveshjes së Huas me Fondin Saudit për Zhvillim nr.
03/693 (Projekti për Rehabilitimin e Rrugës së Lumit të Vlorës)

Bashkëlidhur

KOMENTE

PËRGATITUR NGA /Nënskrimi/

MIRATUAR NGA /Nënskrimi/

Numri i referencës: 22304
Data: 22/4/2020
Bashkëlidhur.....

SFD
Fondi Saudit për Zhvillim

Drejtuar: SH.T. Ministrit të Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Republika e Shqipërisë

Numri i faksit: (+35542228405)

Lënda: Përfundimi/Zgjidhja e Marrëveshjes së Huas me Fondin Saudit për Zhvillim nr. 03/693 (Projekti për Rehabilitimin e Rrugës së Lumit të Vlorës)

Shkëlqesia Juaj,

Në vijim të letrës së Shkëlqesisë suaj, nr. 3132, datë 21.2.2020, në lidhje me objektin e mësipërm, shpreh kënaqësinë t'ju informoj se pranojmë të përfundojmë/zgjidhim Marrëveshjen e Huas së lartpërmendur, me vendimin e bordit **nr.: 2380/125/9**. Në këtë mënyrë, Marrëveshja e Huas ndërpritet që prej datës **29.12.2019**.

Përsëndetjet më të mira,

Me respekt,

Khalid S. ALKhudairy
Zëvendëskryetar dhe Drejtor i Përgjithshëm
/Nënshkrimi/

+966 11 4647450 +966 11 279 4000
P.O Box 50483- Riyadh 11523- Kingdom of Saudi Arabia- Tel+966 11 279 4000 Faks:+966 11 4647450 www.sfd.gov.sa

